



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 20.06.2023

Më datë 20 qershor u zhvillua mbledhja e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat (KKN). Axhenda e takimit ishte:

1. Plani i aktiviteteve në vazhdim për 2023;
2. Informim mbi rishkrimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev 2.1
3. Aktiviteti i Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023;
4. Çështje të tjera

N/Kryetarja e KKN, Znj. Rahela Reçi bëri prezantimin e rendit të ditës e cila u miratua pa ndryshime. Takimi vijoi sipas axhendës.

Plani i aktiviteteve në vazhdim për 2023:

Z. Maldi Dema, përfaqësues i INSTAT diskutoi Planin e aktiviteteve në vazhdimësi, deri në fund të vitit 2023. Theksi u vu në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve mbi klasifikimet. Znj. Rahel Reçi vuri theksin mbi rëndësinë e njohjes së klasifikimeve nga punonjësit e administratës, të cilët janë pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor. Z. Maldi Dema bëri me dije se INSTAT ka ngritur infrastrukturën organizmin e trajnimeve. Anëtarët e KKN duhet të paraqesin kërkesat për trajnime dhe në bashkëpunim me INSTAT të përgatiten modulet dhe të organizohen trajnime.

Znj. Ornella Koleka me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, anëtare e re e KKN-së diksutimin e zhvilloi si më poshtë:

1. Shprehje e kërkesën për trajnim e stafit të ministrisë që mbulon statistikat (staf i ri) mbi “Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011) dhe Fushave të Arsimit dhe të Trajnimit të KSNA 2013 (KSNA-F 2013);
2. MAS aktualisht përdor Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar, në të cilin duhet të integrihet ISCED2011, në mënyrë që të gjenerohen raportet mbi këtë

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 /222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

klasifikim. Sistemi i të Menaxhimit të Sistemi Parauniversitar është ngritur nga AKSHI dhe MAS është institucioni përfitues;

3. Përgatitja nga KKN e shkresës drejtuar ministrive/institucioneve për këkesat e tyre lidhur me klasifikimet. Kjo për faktin që ti jepet më shumë vëmendje nga institucionet mbi ngritjen e kapaciteteve.

Propozimin e Znj. Ornela për pikën 3 të diskutimit u mbështet edhe nga Znj. Edlira Krekas, përfqësuese e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Maldit u shpreh se INSTAT merr përsipër ta përgatisë shkresën dhe pas sugjerimeve nga anëtarët të firmoset nga Kryetari i KKN, por nuk është në përputhje me VKM e funksionimit të KKN. Për çdo nomenklaturë, përcaktohen institucionet mbi zbatimin e Nomenklaturës. Në rastin e ISCED (VKM Nr. 288, datë 11.5.2022) ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, institucionet arsimore parauniversitare, institucionet e arsimit të lartë, institucionet ofruese të arsimit e të formimit profesional dhe prodhuesit e statistikave zyrtare, për zbatimin e nomenklaturës.

Ky Propozim do të diskutohet me Kryetarin e KKN, Znj. Elsa Dhuli dhe do të merret vendimi.

Zbatimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev 2.1

Përsa i përket ecures së trajnimeve për “Klasifikimet e Sëmundjeve sipas grupsëmundjeve ICD-10”, znj. Klea Troka, përfaqësuese nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bëri me dije se do të organizohet së shpejti një takim ndër-institucional për këtë qëllim. Komisioni do të informohet në vijim mbi ecurinë e trajnimeve për ICD10.

Në vijim të axhendës, znj. Flutura Sala prezantoi KKN ndryshimet që ka pësuar NVE Rev 2 (Rregullorja e Komisionit (BE) 2023/137 ndryshoi Rregulloren (KE) Nr. 1893/2006 dhe përcakton versionin e ri të klasifikimit të aktiviteteve ekonomike në BE, NACE Rev2.1).

Eurostat po vijon procesin për finalizimin e udhëzimeve hyrëse të NACE Rev. 2.1, tabelave të korrespondencës dhe shënimeve shpjeguese, si më poshtë:

Versioni përfundimtar i udhëzimeve hyrëse NACE Rev. 2.1 pritet në mesin e Korrik 2023;

Finalizimi i versionit të konsoliduar të tabelës së korrespondencës pritet të bëhet në fund të korrikut 2023;

Shënimet shpjeguese NACE Rev. 2.1 pritet të finalizohen në TM3 2023

Cdo dokument i finalizuar nga Eurostat do u dërgohet anëtarëve të KKN për të qenë të përditësuar mbi ecurinë e zbatimit të NACE Rev2.1.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

NACE është klasifikim që përdoret nga shumë institucione/ agjenci shtetërore.

Znj. Mimoza Sallaku, përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, propozoi që AKSHI të ketë anëtar në KKN duke qenë se është institucioni që ngre dhe mirëmban sistemet e administratës publike. Cdo bazë ligjore e re apo amendime, sjell domosdoshmërinë e aplikimit në databazat që mirëmban AKSHI. E njëjta gjë vlen edhe për klasifikimet.

Z.Maldi Dema propozoi të drejtohej kërkesa në Këshillin e Ministrave e shoqëruar me relacionin shpjegues. Ky proces kërkon inputet nga anëtarët e KKN. Të gjithë anëtarët e vlerësuan të domosdoshëm përfaqësimin e AKSHI në KKN.

Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023

Z. Maldi bëri një prezantim të përgjithshëm të censit të popullsisë dhe banesa, kuadri ligjor dhe rregullator, faza e testimit, fushata publicitare, rekrutimi i stafit, periudha e terrenit etj... Anëtarët e KKN shprehën gadishmërinë për mbështetjen e INSTAT në këtë aktivitet shumë të rëndësishëm jo vetëm si pjesë e administratës , por edhe si qytetarë.

Përgatiti:

Sekretariati i KKN
22 qershor 2023

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al